

Lapušnik, komuna e Glllogocit/Glogovac, bujk, njëmbëdhjetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Rrahmani isigurontetëardhuratpërfamiljen e vet nga bujqësia. Ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Bashkëluftëtarët e kanë parë të gjallë herën e fundit më **26.07.1998**, përderisa ai po merrte pjesë në mbrojtjen e fshatit, kur forcat serbe i sulmuan pozicionet e UÇK-së në **Llapushnik/Lapušnik**. Në datën 26.10.1998, familjarët e tij e kanë gjetur trupin e Rrahmanit në një pyll, në vendin e quajtur *Maden*. Jo larg kufomës ishin edhe gjësende të tij personale. Familjarët e kanë varrosur Rrahmanin në varrezat e Llapushnikut/Lapušnik më 27.10.1998. Atje, ai prehet edhe sot.

Burimet: deklarata R.G, FDH-25881; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 155, FDH-8655.

Hisen (Ahmet) Bujupi

(27.8.1935, shqiptar nga Arllati/Orlate, komuna e Glllogocit/Glogovac, punëtor ndërtimor, shtatë fëmijë)

Në datën **26.07.1998**, forcat serbe e kanë sulmuar **Arllatin/Orlate**. Sulmi e ka detyruar familjen e Hisenit ta braktiste shtëpinë e vet, së bashku me familje të tjera të *Mëhallës Bujupi*. Hiseni ka marr vendim të rrinte në shtëpi. Familja e tij ka qenë e strehuar në *Malet e Berishës/Berišine planine* deri më 20.09.1998. Pas kthimit, ata nuk e kanë gjetur Hisenin në shtëpi. Trupi i tij u zbulua në afërsi të fshatit, në vendin e quajtur *Azemiqe*. Hisenin e kanë varrosur në varrezat e *Mëhallës Bujupi*. Pas përfundimit të luftës, në muajin shtator të vitit 2001, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Hisenit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Arllat/Orlate.

Burimi: deklarata B.B, FDH-18047.

Lulzim (Mehmet) Bujupi

(8.12.1961, shqiptar nga Arllati/Orlate, komuna e Glllogocit/Glogovac, i pamartuar, arsimtar)

Lulëzimi ka qenë arsimtar i historisë në shkollën fillore të Glllogocit/Glogovac. Kur forcat serbe e sulmuan Arllatin/Orlate më

26.07.1998, familjarët e tij dhe banorë të tjerë e braktisën fshatin dhe u strehuan në *Malet e Berishës/Berišine planine*. Ai ka mbetur në shtëpi [**Arllat/Orlate**]. Prindërit e tij dhe banorë të tjerë u kthyen në fshat pas përfundimit të luftës më 14.06.1999. Lulëzimin nuk e gjetën në shtëpi. Vetëm më 11.10.2005, familjarët u njoftuan zyrtarisht nga Instituti për Mjekësinë Ligjore në Rahovec/Orahovac, që mbetjet mortore të Lulëzimit janë zbuluar në varrezat e qytetit në lagjen *Dragodan*, në Prishtinë/Priština, në muajin qershor të vitit 2003, dhe se ishin identifikuar më shumë se dy vjet pas zhvarrosjes së tyre. Në datën 14.10.2005, familjarët i kanë marrë mbetjet mortore të Lulëzimit dhe i kanë varrosur në varrezat e lagjes *Bujupi* në Arllat/Orlate.

Burimet: deklarata M.B, FDH-18051; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 96, 911; KKMKRFJ, *Persona...*, FDH-10832; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Dalip (Smail) Bytyqi

(13.11.1928, shqiptar nga Arllati/Orlate, komuna e Glllogocit/Glogovac, punëtor ndërtimor, katër fëmijë)

Dalipi nuk deshëi ta braktiste shtëpinë e vetë, kur familjarët dhe banorë të tjerë e braktisën fshatin **Arllat/Orlate** [Glogovac/Glllogoc] më **26.07.1998**, duke u fshehur nga forcat serbe që iu afruan fshatit. Familjarët nuk dinin asgjë për fatin e Dalipit deri më 15.01.1999, kur ata u kthyen në shtëpi. Në brendi të saj, e kanë gjetur trupin e pajetë të Dalipit. Kufoma e tij ishte e karbonizuar në mes të mbetjeve të gomave të djegura automobilistike. Po atë ditë, mbetjet mortore të Dalipit u varrosën në varrezat e *Mëhallës Bytyqi*, në Arllat/Orlate.

Burimi: deklarata I.B, FDH-18049.

Zeqir (Bajram) Gashi

(20.12.1913, shqiptar nga Llapushniku/Lapušnik, komuna e Glllogocit/Glogovac, gjashtë fëmijë)

Zeqiri i moshëthyer ka vazhduar së qëndruari në **Llapushnik/Lapušnik**, kur civilë të tjerë, për shkak të luftimeve mes forcave të UÇK-